

KOSOVO



KOMITETI OLIMPIK
OLYMPIC COMMITTEE

Nr. 41/2017

Dt. 08.03.2017

KOSOVA

KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE

Prishtinë, 08.03.2017

Për: Kryetarët dhe Sekretarët e Federatave Sportive të Kosovës

Lënda: Ftesë për nominimin e sportistëve për EYOF Gyor 2017, Hungari

Duke shpresuar se punët po ju shkojnë mirë, më lejoni të ju njoftoj se Komiteti Olimpik i Kosovës është duke bërë përgatitjet për Festivalin Evropian Olimpik për të Rinjë i cili organizohet për herë të 14 në Gyor të Hungarisë nga data 23-29 Korrik 2017.

Komiteti Olimpik i Kosovës merr pjesë për herë të dytë në festivale të tilla. Pjesmarrja e parë ishte ajo në Tbilisi të Gjeorgjisë ku Kosova u përfaqësua me 15 sportist dhe pati një paraqitje solide.

EYOF Gyor 2017, do të jetë një mundësi e mirë për sportistët e Kosovës që të paraqiten dhe tregojnë rezultate më të mira, në mënyrë që këta sportistë të jenë një hap më afër Lojrave Olimpikë për të Rinjë që do të mbahen në Buenos Aires 2018, Argentinë.

KOK-u është duke i analizuar mundësitë financiare për të organizuar një kamp përgatitor për sportistët që do të jenë në listën përfundimtare për këto lojëra.

Andaj duke e ditur rëndësinë e këtij festivali kërkojmë nga ju që të na i dërgoni CV e sportistëve më të mirë që keni, bazuar në rezultatet e arritura deri më tani.

Lista me emra të sportistëve e dërguar nga ju është listë preleminare, deri në aprovimin përfundimtar nga organizatori i EYOF Gyor 2017.

Afati i dërgimit është deri më **14.03.2017 e Martë ora 15:00**, CV dërgohen në këtë e-mail jeton.rudari@gmail.com.

p.s të bashkëngjitur gjeni formën e CV (e pranueshme është vetëm CV me formularin e dërguar nga KOK-u), udhëzuesin, si dhe linkun e faqës zyrtare të EYOF Gyor 2017.

Me respekt,

Shasivar Haxhijaj,

Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Olimpik të Kosovës

